



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:175358
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05643814

Ac.nr.3409/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B., kundër të paditurit B.S., nga Peja të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë S.M., dhe Q.M.-M., avokat në Pejë, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.957/19, të datës 10.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.957/19, i datës 10.03.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.957/19, të datës 10.03.2021, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar, kërkesëpadia e paditëses Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me çka ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit Dogana e Kosovës t’ ia kompensoj dëmin në lartësi prej 7260.13 euro, që është shkaktuar si pasojë e mos pagimit të detyrimeve doganore me kamatë ligjore, dhe shpenzimet e procedurës deri në përfundimin e kontestit, në afat prej 15 ditësh e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. II. OBLIGOHET, paditësja Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që të paditurit B.S. nga Peja, t’ ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 291 €, në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit, pjesa tjetër përtej shumes se aprovuar për shpenzimet e procedurës, refuzohet si e pa bazuar”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovon ankesën e paditëses në tërësi si të bazuar në ligj, ta prish aktgjykimin e atakuar C.nr.957/19, të datës 10.03.2021, ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, ose lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 14.03.2013, në Gjykatën Themelore në Pejë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit, me propozim që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses si e bazuar dhe të detyrohet i padituri, që paditëses t'ia kompensoj dëmin në shumë prej 7,260.13 euro, si pasoj e mospagimit të detyrimeve doganore, me kamatë ligjore, dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditëve nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata Themelore në Pejë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.215/13, të datës 08.07.2015, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.215/13, të datës 08.07.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.07.2019, ka marrë aktvendim Ac.nr.3381/15, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurit, dhe e ka prishur në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.215/13, të datës 08.07.2015, dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, pasi që lënda i është kthyer në rigjykim dhe rivendosje, ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor, dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.957/19, të datës 10.03.2021, me të cilin në pikën I e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa në pikën II e ka obliguar paditësen që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyqimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar së pas vlerësimit të provave të administruara dhe duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, ka ardhur në përfundim së në këtë çështje juridike- civile duhet vendosur si në dispozitiv të aktgjykimi, për shkak se

padia e paditëses për kompensim dëmi të shkaktuar nga vepra penale është parashkruar, meqë ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Gjykata ka konstatuar së me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik, nën shenjë P.nr. 27/08, të dt. 22.12.2009, i padituri është shpallur fajtor për veprën penale Shmangiet mashtruese nga pagesa e detyrimeve, nga neni 92 par.2 të Kodit Unik Doganor të Kosovës, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë në atë periudhë kohore, nën shenjë Ap.nr. 46/2010, të dt. 23.10.2012, është refuzuar propozim akuza kundër të paditurit, nën arsyetimin se është bërë parashkrimi i ndjekjes penale meqë ka kaluar dyfishi i kohës së kryerjes së veprës penale. Gjykata, këtyre dy provave në veçanti ia ka falur besimin, për shkak se konsistojnë në prova të besueshme dhe me bazë që e argumentojnë ligjërisht dispozitivin e aktgjykimit.

Ndërkaq, provat të cilat pala paditëse i ka prezantuar si prova gjatë rishqyrtimit të kësaj çështje juridike kontestimore siç ishin Aktvendimi 04.3.2-446/27 11.2007, dt. 30.11.2007, Shtojca nr. 1, dhe Përgjigjja në gjuhën greke e dorëzuar si provë nga paditësja e dt. 05.10.2004, gjykata i ka vlerësuar por nuk i mori në konsideratë si prova vendimtare për vendosje ndryshe nga si u vendos në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që me asnjërin nga to nuk mund të ndryshohej rrethana e parashkrimit, e meqë pala paditëse nuk parashtrroi ndonjë provë të re me të cilën do të argumentonte të kundërtën e kësaj rrethane (*parashkrimit*).

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas nenit 341 par.3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku thuhet se: “*gjykata nuk mund të thirret në parashkrim, nëse debitori nuk thirret në të*”, si dhe nenit 358 par.1 dhe 2, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjithashtu duke vlerësuar si të bazuara ligjërisht pretendimet e palës së paditur të paraqitura edhe në parashtresën e dt. 16.12.2020, e cila thirret në parashkrimin absolut të ndjekjes penale nga kryerja e së cilës edhe ka lindur ky kontest gjyqësor, e pasi që gjykata vendosë lidhur me parashkrimin vetëm me kërkesë të palës, sipas përkujdesjes që veprimet procedurale në rigjykim, gjatë gjithë procedurës të jenë në harmoni me sugjerimet e Gjykatës së Apelit, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 341 par.3 dhe 358 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 449, 452, 453 dhe 463 par.1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as në shkelje të cilat pretendohen me ankesë, përveç se gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale pasi që i ka aplikuar dispozitat e Ligjit nr. 04/1-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ligj nuk ka qenë në fuqi në kohen kur paditësja pretendon së i është shkaktuar dëmi, por që kjo rrethanë nuk ka ndikuar në mënyrën e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Pala paditëse në ankesë ka pretenduar për shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së, me arsyetimin së dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor nga ajo që thuhet në arsyetim, në arsyetim të aktgjykimit nuk i ka theksuar faktet vendimtare, ndërsa shkaqet të cilat i ka theksuar nuk janë plotësisht të qarta pasi që nga dispozitivi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet së a është refuzuar kërkesëpadia e paditëses për shkak të parashkrimit apo për shkak së paditësja nuk ka mundur ta vërtetoj bazën juridike për kompensimin e dëmit. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, ky pretendim është i pabazuar, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të qarta për faktet vendimtare dhe se të gjitha arsyet e paraqitura janë të qarta dhe mbi bazën e tyre është nxjerr përfundimi për çështjen objekt shqyrtimi. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar kundërshtimin në parashkrim të paraqitur nga pala e paditur, ka paraqitur arsye të qarta për faktet vendimtare dhe duke u bazuar në kohën kur është shkaktuar dëmi dhe kohën kur është paraqit padia në gjykatë është dhënë vlerësimin në lidhje me çështjen e parashkrimit të kërkesëpadiës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Është i pa qëndrueshëm pretendimi ankimor i paditëses në këtë drejtim pasi që në rastin konkret i padituri është thirrur në parashkrim të kërkesëpadiës dhe mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me kohën kur pala paditëse ka pësuar dëmin e pretenduar si dhe kohën kur është paraqitur padia në gjykatë. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton së paditësja përmes padisë së paraqitur në gjykatë me datë 14.03.2013, ka kërkuar kompensimin e dëmit nga i padituri si pasoj e mos kryerjes së obligimeve doganore, për çka i padituri në procedurë penale me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik, P.nr.27/08, të datës 22.12.2009, ishte shpallur fajtor për veprën penale shmangie mashtruese nga neni 92 par.1, pika a) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/1 mbi Kodin Doganor të Kosovës, për të cilën është gjykuar me dënim me burgim me kusht, dhe ishte obliguar që të dëmtuarës, në këtë rast paditëses në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 10,651.66 euro, për shkak së gjatë periudhës kohore prej 07.10.2004, deri me datë 17.10.2005, me rastin e importimit gur të granitit dhe të mermerit ka deklaruar mallin e importuar me certifikata të pavërteta duke e nënvlerësuar kualitetin e mallit. Ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP.nr.46/2010, të datës 23.10.2012, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik, P.nr.27/2008, i datës 22.12.2009, ashtu që ndaj të paditurit është refuzuar propozim akuza konform dispozitës së nenit 389 par.4, lidhur me neni 91 par.6 të KPPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ndërsa pala e dëmtuar, këtu paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike Gjykata e Apelit, e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së kërkesëpadiës e paditëses është përfshirë në parashkrim.

Në bazë të nenit 376 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD), i cili ligj ka qenë në fuqi kur është shkaktuar dëmi i pretenduar, është paraparë së *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari*

ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Tutje paragrafi 2 i këtij neni përcakton “Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”. Ndërsa në bazë të nenit 377 par.1 të LMD-së është paraparë së “Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”. Kurse sipas nenit 360 par. 1 dhe 2 të njëjtë ligj është paraparë së “Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Në rastin konkret pala paditëse përmes padisë e kërkon kompensimin e dëmit që ia ka shkaktuar i padituri për shkak të mos pagimit të detyrimeve doganore i cili ka ardhur si rezultat i nënvlerësimit të mallit për gjatë periudhës 07.10.2004, deri me datë 17.10.2005, ndërsa padinë për kompensimin e këtij dëmi e ka paraqitur në gjykatë me datë 14.03.2013, e që rezulton së padinë e ka paraqitur në gjykatë pas kalimit të mbi shtatë (7) viteve, bazuar në datën e fundit të kësaj periudhe, andaj në këtë rast kërkesa e paditëses për shpërblimin e dëmit është parashkruar pasi që ka kaluar afati subjektiv dhe objektiv i paraparë me dispozitën e nenit 376 të LMD-së. Për me tepër, edhe nëse e marrim për bazë dispozitën e nenit 377 par.1 të LMD-së, ku parashihet afati i parashkrimit kur dëmi është shkaktuar me vepër penale, edhe në këtë rast rezulton së kërkesëpadia e paditëses është parashkruar pasi që paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë pasi që ka skaduar koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, pasi që siç është theksuar me sipër Gjykata e Qarkut në Prishtinë, e ka refuzuar propozim akuzën konform dispozitës së nenit 389 par.4, lidhur me nenin 91 par.6 të KPPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, për veprën penale për të cilën është akuzuar i padituri dhe për të cilën ishte shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë.

Për me tepër, duke qenë së pala paditëse në procedurë penale kishte paraqitur kërkesë pasurore juridike, dhe duke qenë së pas refuzimit të propozim akuzës për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, pala e dëmtuar, këtu paditësja me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP.nr.46/2010, të datës 23.10.2012, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, kjo gjykatë pati parasysh edhe nenit 390 par.1 të LMD-së ku është paraparë së “Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të inkompetencës së gjykatës ose të ndonjë shkaku tjetër, që nuk përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri ngrit padinë brenda afatit prej tre muajsh nga data kur vendimi i hedhur poshtë e të padisë të ketë marrë formën e prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë”. Paragrafi 2, i këtij neni përcakton se “E njëjta gjë vlen edhe për invokimin në mbrojtje, si dhe për theksimin e kompensimit të kërkesës në kontest, si dhe në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e vet të do ta realizojë atë procedurën ndërgjyqësore”. Megjithatë, Gjykata e Apelit, gjeti së paditësja ka dështuar që të paraqet padinë në afat prej tre (3) muajve në mënyrë që të konsiderohet së i njëjti e ka ndërprerë parashkrimin me paraqitjen e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale, ashtu sic përcaktohet me dispozitat e larcckura. Kjo pasi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP.nr.46/2010, të datës 23.10.2012, me të cilin refuzuar propozim akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, dhe me të cilin e paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil është marrë me datë 23.10.2012, ndërsa këtë aktgjykim paditësja në cilësi të të dëmtuarës e ka pranuar me datë 12.11.2012, që vërtetohet nga vula e protokollit të paditëses, kurse padinë e ka

paraqitur në gjykatë 14.03.2013, që i bie pas katër muajve. Nga këto arsye rezulton së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë së kërkesa e paditëses është përfshirë në parashkrim është i drejtë, edhe pse në këtë rast e njëjta gabimisht i ka zbatuar dispozitat ligjore duke e aplikuar LMD e cila nuk ka qenë në fuqi, por që kjo rrethanë nuk ka ndikuar në mënyrën e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Vendimi me të cilin pala paditëse është obliguar që palës së paditur t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në pajtim me dispozitat e nenit e neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3409/2021, datë 18.04.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Hysni Bardheci